



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:166696

Datë: 16.01.2023

Numri i dokumentit: 03859767

A.nr.2048/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditëses K.K, të cilën e përfaqëson me autorizim bashkëshorti i saj R.K, kundër të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti i Administratës Pensionale me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit me numër, në shqyrtimin kryesor publik, në prani të përfaqësuesit të palës paditëse dhe mungesë së palës së paditur, me datë 21.12.2022 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet kërkesëpadia e paditëses, K.K si e bazuar.

II.ANULOHET vendimi i të paditurës, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, me numër të ankesës 872, i datës 02.11.2020 dhe vendimi i shkallës së parë dhe paditëses të i njihet e drejta e kompensimit për personat paraplegjik dhe tetraplegjik në grupin e parë nga data 01.06.2020 deri me datën 24.06.2022.

III.DETYROHET e paditura, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, që paditëses t'i kompensojë në mënyrë retroaktive pagesën në emër të drejtës në kompensimin për personat paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë, për periudhën kohore që nga data e ndërprerjes të drejtës në kompensimin për personat paraplegjik dhe tetraplegjik - datë 01.06.2020 deri me datën 24.06.2022, dhe atë në vlerën e caktuar prej 375 euro (treqind e shtatëdhjetë pesë euro) për çdo muaj, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga marrja e aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë

IV. Ky aktgjykimi i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, në prani të përfaqësuesit të palës paditëse, R.K, në mungesë të palës së paditur e ftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore.

Paditësja, në padinë e datës 30.11.2020, ka kërkuar nga gjykata që aprovet padia e paditëses, anulohet vendimi i kontestuar i të paditurës, dhe t'i njihet e drejta për kompensim për persona paraplegjik dhe tetraplegjik në grupin e parë nga dita e paraqitjes e kërkesës.

Përfaqësuesi i paditëses, në fjalën e tij në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: “kërkoj nga gjykata që të aprovet padia e paditëses si e bazuar dhe të anulohet vendimi kontestues i të paditurës i datës 02.11.22 me nr. të ankesës 872 me të cilën i është refuzuar e drejta e pensionit për personat paraplegjik dhe tetraplegjik. E njoftoi gjykatën se në vitin 2017 paditëses i është njohur kjo e drejtë e pensionit në kategorinë e dytë në shumën prej 150 euro ndërsa kjo e drejtë është refuzuar me data 28.06.2020, pa verifikim të gjendjes shëndetësore të paditëses. Gjithashtu e njoftoi gjykatën se e paditura me vendimin e datës 19.08.2022 i është njohur e drejta e këtij pensioni në kategorinë e parë në mënyrë retroaktive në shumën prej 1,125.00 €, andaj nga kjo konsideroi që paditëses i është bërë e padrejtë dhe kërkoj nga gjykata të anulohet vendimi kontestues i datës 02.11.22 dhe ti njihet e drejta e kompensimit për personat paraplegjik dhe tetraplegjik në kategorinë e parë nga muaji qershor 2020 deri me datën 24.06.2022.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 20.09.2022, e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar duke theksuar se aktvendimi i atakuar është marrë konfrom të gjitha dispozitave në fuqi dhe njëherit i propozon gjykatës që pas administrimit të provave të marr aktgjykim për refuzimin e kërkesëpadiës së paditëses në tërësi si të pabazuar, duke lënë në fuqi vendimet e të paditurës.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, në përputhje me nenin 43.3 dhe 67 të Ligjit për Konflikte Administrative ashtu që vendosi që vetë meritorisht ta vendosë këtë çështje administrative. Gjykata duke vlerësuar e vendimin e goditura me padi, në përputhje me nenin 44.3 dhe nenit 67 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, thënieve të padisë, përgjigjes së dhënë nga e paditura ka gjetur se kërkesëpadija e paditëses është e bazuar.

Me vendimin e shkallës së dytë të MPMS-së, Departamenti i Pensioneve të datës 02.11.2020, të goditur me padi, është refuzuar ankesa e paditësit në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet ligjore.

Nga vendimet kontestuar, del se ato përmbajnë të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tyre. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 48 të këtij ligji është paraparë: “1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”.

Aktvendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se: “Z/znj. K.K ka parashtruar ankesë më datë 28.08.2020 për njohjen e të drejtës në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave në lëndë, është vërtetuar se ankesa e juaj nuk është në harmoni me pikën 1 dhe 2 të nenit 7 dhe pikën 1 të nenit 8 të Ligjit 05/L-067. Bazuar në vlerësimin e Komisionit Mjekësor të datës 13.10.2020, nga mjekë specialist të lëmisë përkatëse, i cili ka bërë ekzaminimin e dokumentacionit mjekësor të bashkangjitur në ankesë dhe ka konstatuar që nuk janë plotësuar kriteret ligjore për kompensim për persona Paraplegjik dhe Tetraplegjik, prandaj ankesën e refuzon si të pa bazuar.

Në rastin konkret gjykata gjeti se, e paditura në arsyetimin e vendimit të atakuar nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme, nuk ka administruar asnjë provë nga e cila mund të vërtetohet fakti se paditësja nuk i plotëson kriteret e parapara ligjore për të fituar statusin e personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, por vetëm ka dhënë një arsyetim të përgjithshëm duke u thirrur në nenin 7 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenin 8 paragrafi 1 të Ligjit nr.05/L-067 për Statusin e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

Gjykata për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, i'u referua Ligjit 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, përkatësisht nenit 1 me të cilin është përcaktuar që “Me këtë ligj rregullohet statusi dhe të drejtat e personave, të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme apo personave të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme të cilët marrin kompensim mujor”, ndërsa neni 3 paragrafi 1, nën par. 1.1. , me të cilin është përcaktuar që “Paraplegjikët – janë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë

humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme”, ndërsa me nenin 8 paragrafi 1 të po të njëjtit ligj është përcaktuar që “Përfituesve të këtij ligji u njihet e drejta për një kujdestar personal, në bazë të vlerësimit nga komisioni vlerësues, me qëllim të ofrimit të kujdesit dhe shërbimeve të domosdoshme ditore, e të cilët kompensohen në shumën e njëjtë sikurse përfituesit e këtij ligji”.

Më tej, neni 4 i të njëjtit ligj përcakton se, Përfituesit e këtij ligji mbrohen nga të gjitha llojet dhe format e diskriminimit, shfrytëzimit, abuzimit, fyerjes dhe gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët bazuar në Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të njohura nga Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut e me theks të veçantë me standardet dhe parimet e përcaktuara me Konventën Ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.

Ndërsa me Rregulloren NR. 07/2017 Për Përbërjen, Funksionin, Përgjegjësinë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, përkatësisht nenin 5 paragrafi 1 i saj janë përcaktuar Funksioni dhe Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues ku është paraparë që :1. Komisioni Vlerësues ka këto funksione dhe përgjegjësi: 1.1.Ekzaminimin e parashtruesit të kërkesës; 1.2. Vlerësimin e grupimit dhe nevojave sociale të personave paraplegjik dhe tetraplegjik, e cila bëhet duke u bazuar në dokumentet mjekësore, mendimin konziliar nga Klinika e Neurologjisë-QKUK, si dhe ekzaminimit nga ana e Komisionit Vlerësues; 1.3. Përfituesit e grupit të parë janë persona me pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve; 1.4. Përfituesit e grupit të dytë janë persona që nuk kanë pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve; 1.5. Përcaktimin e nevojës për edukim dhe arsimin; 1.6. Përcaktimin e nevojës për rehabilitim; 1.7. Përcaktimin e nevojës për kujdestar personal.”

Ndërsa neni 9 i po kësaj rregulloreje ka paraparë procedurën e Rivlerësimit ku është përcaktuar që “Në bazë të vlerësimit të Komisionit Vlerësues, përfituesit e grupit të parë me pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve do t’i nënshtrohen rivlerësimit në çdo pesë vite, kurse për përfituesit e grupit të dytë që nuk kanë pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve rivlerësimi konform Ligjit Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

Prandaj, për faktin se, paditësja ka ofruar dëshmi të mjaftueshme lidhur me invaliditetin e tij, dhe duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, gjykata, kërkesë-padinë e tij e aprovoi si të bazuar, dhe si rrjedhojë e

detyroi të paditurën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi pasi që gjykata gjeti se paditësja, me vendimin e atakuar, i'u ka cënuar e drejta e kompensimit në pensionit praplegjik dhe tetraplegjik, pasi që edhe vet e paditura me vendim e mëvonshëm të datës 19.08.2022, ka aprovuar ankesën e paditëses, dhe i është miratuar kërkesa e znj. K.K në kompensimin për personat parpelgjik dhe tetraplegjik te grupit të parë prej datës 24.06.2022, në shumen mujore prej 375 euro (treqind e shtatëdhjetë pesë euro). Nga kjo rezulton se, paditësja, në momentin e ekzekutimit të vendimit kontestues, i është shkaktuar dëm, ngase e njëjta nuk ka mundur të realizoj plotësisht të ardhurat që kanë buruar nga e drejta në shfrytëzimin e pensionit praplegjik dhe tetraplegjik nga data e refuzimit të kërkesës/ ndërprerjes datë 01.06.2020.

Duke marr për bazë këtë, gjykata ka vlerësuar se paditura sa i përket kompensimin për personat parpelgjik dhe tetraplegjik të grupit të parë ka vlerësuar në mënyrë të drejtë, mirëpo, nuk është lëshuar në vlerësimin e çështjes së kompensimit retroaktiv të kësaj të drejte, andaj, lidhur me këtë pikë vendimi kontestues është anuluar si i pa bazuar, dhe si rezultat ka vendosur që paditëses t'i njihet e drejta në kompensimin e personave paraplegjik dhe tetraplegjik, që nga dita kur i është refuzuar/ ndërprerë kjo e drejt (shih vendimin e datës 11.17.2017, ku paditësja e ka realizuar këtë të drejtë nga data 01.05.2017 për tre vite radhazi deri në muajin qershor 2020) datë 24.06.2020, paditëses i është refuzuar kjo e drejt, deri kur i është njohur përsëri datë 24.06.2022 me vendimin e datës 19.08.2022, dhe ka vendosur që kompensimin në emër të kësaj të drejte t'i bëhet në mënyrë retroaktive pasi që baza juridike e kërkesëpadiisë është krijuar me anulimin e vendimit për refuzimin e kësaj të drejte.

Fakti se Republika e Kosovës, në Kushtetutën e saj, neni 22, ka marrë përgjegjësi për zbatimin e Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare që kanë për qëllim respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të gjithë personave pa dallime, në këtë kontekst dhe e paditura duke pasur parasysh se kjo kategori e personave ka nevoja të veçanta, është në mandatin e saj të zhvillojë politika dhe të krijojë mundësi të barabarta për këta persona që të gëzojnë shërbime për nevojat e tyre dhe që shkojnë në mbrojtje të dinjitetit të kësaj kategorie, ashtu që të jenë pjesë aktive dhe e dobishme e zhvillimit të gjithmbarshëm të shoqërisë.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e të paditurës të dhëna në vendimin kontestues dhe përgjigjen në padi, por të njëjtin e refuzoi si të pa bazuar dhe pa argumentuara, këtë bazuar në provat e lartcekura dhe për faktin se vet e paditura ka nxjerrë vendim që i'a njeh këtë të drejtë paditësit, e që nënkupton se e paditura në rastin e paditëses e ka konstatuar drejtë gjendjen faktike sa i përket të drejtës së kompensimit të personave paraplegjik dhe tetraplegjik kishte aplikuar gabimisht të drejtën material duke mos ja njohur edhe këtë të drejt në mënyrë retroaktive pagesën në emër kompensimit të personave paraplegjik dhe tetraplegjik në kategorinë e parë në shumen prej 275 euro për periudhën kohore të lartcekur.

Ndërsa, me nenin 17 të Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktin Administrativ është paraparë që “Në procedurën e konfliktit administrativ mund të kërkohet edhe kthimi i sendeve të marra, si dhe kompensimi i dëmit që i është shkaktuar paditësit me ekzekutimin e aktit që kontestohet”. Po ashtu e paditura me vendimin e atakuar i’ka mohuar paditëses të drejtën për shfrytëzimin e te drejtës së lartcekur nga data 01.06.2020, kur i është refuzuar kërkesa për realizimin e të drejtës në pension paraplegjik dhe tetraplegjik. Nga kjo rezulton se paditësja në momentin e ekzekutimit të vendimit kontestues i është shkaktuar dëm ngase e njëjta nuk ka mundur të realizoj të ardhurat që kanë buruar nga e drejta në shfrytëzimin të këtij pensioni, andaj, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me përcaktimin e lartësisë së shumës në kompensimin e personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, gjykata iu referua Ligjit Nr.05/L-067 për Statusin e dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, përkatësisht nenit7 par. 1 dhe 2, ndërsa kompensimi i kujdestarit personal është përcaktuar me nenin 8 par.1 i po këtij ligji.

Kjo gjykatë vlerësoj edhe pretendimet e të paditurës të dhëna në përgjigje se paditësi nuk i ka plotësuar kriteret për njohjen e këtij pensioni mirëpo si të tilla kjo gjykatë pasi i vlerësoj i refuzoj si të pabazuara pasi nuk i pa me ndikim në një vendimmarrje tjetër nga vërtetimi dhe vendosja si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43.3, 46.2, 5 lidhur me nenet 5, 6, 38 dhe 65 Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 63 e lidhur me nenin 21 Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin Ligjit, Nr.03/L-006 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.2048/2020- datës 21.12.2022

G j y q t a r e
Luljeta Maxhuni

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.